REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fajl/Br.sv. 373
Data/Datum 20. 11. 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**

**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE**

**Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e tetë e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 28.09.2026, në ora 10:00h, në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.**

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa:** Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Filloreta Musaj, Rrahim Sogojeva, Laureat Gojnovci, Dardane Sogojeva Shala dhe Ali Ismaili.

**Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës:** Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Buxhet dhe Financa.

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 01.09.2026.
2. Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 dhe Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2027.
3. Propozim për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026.
4. Propozim për rishqyrtimin e vendimit dhe ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.
5. Propozim për ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
6. Propozim për rishqyrtimin e ndryshim-plotësimit të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026.
7. Shqyrtimi i dytë dhe ndryshim-plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale.
8. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Planit Lokal për avansimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkalinjë të Komunës së Fushë Kosovës për 2026-2029.
9. Informatë për performancën e Komunës së Fushë Kosovës në vitin 2025.
10. Propozimit për transferimin - rialokimin e mjeteve financiare për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi'.
11. Propozim për transferimin - rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën-programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës.
12. Propozim për transferimin - rialokimin e mjeteve financiare për nën-programin Infrastruktura Rrugore.
13. Të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, po e hapim zyrtarisht mbledhjen, po filloj me leximin e pikave të rendit të ditës dhe hapi diskutimin.

**Drejtori për Buxhet dhe Financa:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Dua të sqaroi se vendimi për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi' në shumë të mjeteve financiare prej: 450,000.00€, nuk është pranuar, andaj duhet ta shfuqizojmë vendimin dhe ta marrim një vendim tjetër me reduktim të shumës së mjeteve financiare prej: 373,500.00€, që është nën 25% të kodit të projektit dhe vendos Qeveria e Kosovës, për rrugën 'Prekadini' në Infrastrukturën Rrugore, e kemi propozimin tjetër në shumë të mjeteve financiare prej: 162,000.00€ dhe propozimi në arsim në shumën e mjeteve financiare prej: 256,000.00€.

**Rrahim Sogojeva:** Përshëndetje kolegë, ne pajtohemi me rendin e ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe pikat shtesë të sqaruara nga Drejtori për Buxhet dhe Financa.

**Laureat Gojnovci:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje, faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, ne jemi dakort për shqyrtim të pikave të propozuara, por jo me pikat shtesë që janë bërë dukuri e zakonshme, i kemi marrë më shumë se dhjetë vendime për modifikimin e projekteve kapitale dhe kalimin e buxhetit në mallëra dhe shërbime.

**Dardane Sogojeva Shala:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, sa i përket pikave të rendit të ditës të propozuara për shqyrtim edhe unë pajtohemi që të aprovohen, por nuk pajtohem që të shqyrtohen edhe tre pika shtesë.

**Ali Ismaili:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pajtohem me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, por duhet ta kemi një standard të vendosim në bazë të rregullave të punës së Kuvendit, jo të shqyrtojmë material tjera me pika shtyesë, po vazhdoni me avazin e vjetër, kjo punë nuk është në rregullë kështu, anëtari i Kuvendit të Komunës duhet të jetë i përgatitur me material shtatë ditë përpara, sepse nuk është profesionistë në secilën fushë, i duhen konsultime shtesë, me profesionistë të fushave përkatëse.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, theksoi se tani po e qesim në votim 'Propozimin për transferimin - rialokimin e mjeteve financiare për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi'.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë pjesëmarrës në votim, nga gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave aprovohet për shqyrtim në rendin e ditës pika shtesë: Propozimi për transferimin - rialokimin e mjeteve financiare për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, theksoi se tani po e qesim në votim 'Propozimin për transferimin - rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën-programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës'.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë pjesëmarrës në votim, nga gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave aprovohet për shqyrtim në rendin e ditës pika shtesë: Propozimi për transferimin - rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën-programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, theksoi se tani po e qesim në votim 'Propozimin për transferimin - rialokimin e mjeteve financiare për nën-programin Infrastruktura Rrugore'.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë pjesëmarrës në votim, nga gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave aprovohet për shqyrtim në rendin e ditës pika shtesë: Propozimi për transferimin - rialokimin e mjeteve financiare për nën-programin Infrastruktura Rrugore.
Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, theksoi se tani po e qesim në votim rendin e ditës me tre pikat shtesë të aprovuara për shqyrtim në mbledhjen e sotme.
U votua me: tre vota 'për', tre vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë pjesëmarrës në votim.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, meqë rezultati ishte I barabartë përdori votën e dyfishtë dhe konstatoi se me shumicë të votave aprovohet për shqyrtim në rendin e ditës me tre pikat shtesë.

**Pika e parë (1) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 01.09.2026.**
**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Tani e kemi për shqyrtim për vërejtjet apo sugjerimet tuaja 'Ekstraktin e Procesverbalit të mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e mbajtur me datën 01.09.2026'. Hap diskutimin.
**Rrahim Sogojeva:** Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovimin 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 01.09.2026'.
**Laureat Gojnovci:** Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, ne nuk e votojmë, ekstraktin e procesverbalit, sepse po shkelet Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës.
**Dardane Sogojeva Shala:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Mendoj që është shkelur Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës, nuk po bëhen audio-incizimet, andaj ne jemi kundër.
**Ali Ismaili:** Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 01.09.2026, nuk kam vërejtje, por po kalojnë tani nëntë muaj dhe nuk ka ndonjë përmirësim esencial nga e kaluara, andaj edhe unë jam kundër.
**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Tani po e qesim në votim për aprovim 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur me datën 01.09.2026'.
U votua me: tre vota 'për', tre vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, meqë votat ishin të barabarta përdori votën e dyfishtë dhe konstatoj se aprovohet 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur me datën 01.09.2026'.

**Pika e dytë (2) - Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 dhe Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2027.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 dhe Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2027'. Hap diskutimin.

**Filloreta Musaj:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, falenderojmë Ekzekutivin e Komunës, që e ka hartuar Kornizën Afatmesme Buxhetore, duke u bazuar në nevojat e qytetarëve, andaj ne e mbështesim këtë Kornizë buxhetore dhe planifikimin e buxhetit për vitin 2027 dhe propozojmë që të procedohet për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

**Laureat Gojnovci:** Sot po e diskutojmë dokumentin më të rëndësishëm të komunës për një vitë, qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës janë gënjyer, se do të mbahen dëgjime publike buxhetore në secilin vendbanim, ato nuk kanë ndodhur, janë mbajtur vetëm në fshatrat: Bardh i Madh dhe Graboc i Poshtëm, ku nuk ka patur pjesëmarrje të kënaqshme dhe dëgjimet publike janë ndalur. Po e përmendi për sqarim, vetëm një projekt kapital te Zhvillimi Ekonomik 0411, renovimi - ngjyrosja e objekteve banesore në lagjen e Bresjes, si kod do të duhet të ishte në kuadër të Drejtorisë së re të Mirëqenies Sociale, apo Infrastrukturës Publike. Ndërtimi i tabelave në qytet dhe fshatra pse prapë te Zhvillimi Ekonomik, kjo përbën keqëklasifikim në shpërndarjen e projekteve kapitale, aty ku nuk e kanë vendin e tyre. Nga 110 premtime të Kryetarit të Komunës, shumica prej tyre nuk janë në buxhet, as në vlerësimet e hershme, më gjerësisht shumicën prej tyre, do t'i prezantojmë nesër në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, që të mos përsëritemi.

**Dardane Sogojeva Shala:** Nuk e përkrahim këtë 'Planifikim të buxhetit për vitin 2027', sepse nuk përfshinë shumicën e projekteve kapitale, që u janë premtuar qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës

**Ali Ismaili:** Sot kemi një nga pikat më të rëndësishme të vitit dhe nuk e kemi prezentë Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës dhe as pjesën më të madhe të Ekzekutivit të Komunës, ne në mbledhje të Kuvendit të Komunës i kemi vetëm 5 minuta për diskutim, unë kërkoj që kur janë tema me rëndësi sikur janë: planifikimi i buxhetit, apo shpenzimi i tij, të kemi një kohë më të gjatë, të arsyeshme nga ana e juaj Kryesues i Kuvendit të komunës, për ta shprehur drejtë qëndrimin tonë. Buxheti është i madh, po fokusohem më shumë tek Investimet Kapitale, shifrën e kemi diku 11,413,304.00€, ku na mungojnë 'Pip-at për projekte kapitale', nëse e marrim një shumë dy qind mijë euro për rrjete të kanalizimeve në fshatin Bardh i Madh apo edhe në ndonjë fshat tjetër, duhet ta dijmë ku në cilat rrugë, do të kryhet kjo punë. Nuk jemi të sinqertë, po vazhdoni me avazin e vjetër, nuk sqaroni asgjë, materiali për buxhetin një vjeçarë të komunës është i pa plotë, nuk dihet saktë se çka do të investohet. Investimet kapitale, nuk duhet të jetë katalog dëshirash, kërkojë llogari lokacionin ku punohet, sasinë e punimeve, afatin dhe kriteret reale dhe jo premtime, që në teren nuk kanë asnjë efekt për qytetarët, për këto arsye, unë nuk mund ta mbështesë këtë buxhet.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: Meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 dhe Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2027'.

U votua me: tre vota 'për', tre vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përdori votën e dyfishtë, meqë votat ishin të barabarta, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 dhe Buxheti i Planifikuar i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2027', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 dhe Buxhetin e Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2027'.

**Pika e tretë (3) - Propozim për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026.**
**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026, është vetëm plotësim, ku vendimit të datës 24.02.2027, i shtohet fjala 'Për të rriturit' me 'Sindromin doën dhe autizëm'. Hap diskutimin.
**Ali Ismaili:** Pse Drejtoresha për Shëndetësi nuk është prezentë prezente të na elaborojnë pikën e saj, është nder Kryesues i Kuvendit të Komunës, që të kërkohet përgjegjësi, të dërgohet dikush nga Drejtoria përkatëse. Me gjithë atë unë pavarësisht rrethanave e mbështes këtë propozim.
**Dardane Sogojeva Shala:** Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026, të cilit i shtohet fjala 'Për të rriturit' me 'Sindromin doën dhe autizëm'.
**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: Tani po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026, është vetëm plotësim, ku vendimit të datës 24.02.2027, i shtohet fjala 'Për të rriturit' me 'Sindromin doën dhe autizëm'.
U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa, e procedon për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026, është vetëm plotësim, ku vendimit të datës 24.02.2027, i shtohet fjala 'Për të rriturit' me 'Sindromin doën dhe autizëm', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026, është vetëm plotësim, ku vendimit të datës 24.02.2027, i shtohet fjala 'Për të rriturit' me 'Sindromin doën dhe autizëm'.

**Pika e katërt (4) - Propozim për rishqyrtimin e vendimit dhe ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.**
**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** E kemi në rishqyrtim për arsye të kuotës gjinore 'Propozimin për rishqyrtimin e vendimit dhe ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa', ku propozojmë zëvendësimin e z. Gjelbrim Halili nga Aleanca me znj. Arlinda Mekolli. Hap diskutimin.

**Rrahim Sogojeva:** Në emër të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financva nga Grupi Parlamentoarë i Lëvizjes Vetëvendosje, pajtohemi me aprovimin dhe procedimin për shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për rishqyrtimin e vendimit dhe ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa', me zëvendësimin e z. Gjelbrim Halili nga Aleanca, me znj. Arlinda Mekolli.

**Laureat Gojnovci:** Tani vetë fakti që e keni sjellë ndyshimin e Komitetit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e keni ditur që kalon propozimi për znj. Arlinda Mekolli, e cila kalon në përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa. Ne si Grup Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk pajtohemi që Lëvizja Vetëvendosje të ketë katër anëtarë, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës në Fushë-Kosovë vetëm një, kjo punë nuk shkon kështu sepse është ligji që e përcakton këtë punë, në bazë të përfaqësimit të subjekteve brenda Kuvendit të Komunës, fuqisë së votës, ju po e përdorni arrogancën e numrave dhe po na detyroni neve që këtë çështje ta procedojmë për shqyrtim dhe vendosje në Gjykatë, ku mund të bllokohet puna e Komitetit për Politikë dhe Financa. Kërkojmë nga ju Kryesues i Kuvendit të Komunës, që ta ndaloni këtë process të pa drejtë, do të vijmë në situatë, ku do të bllokohet puna. Propozimi ynë për anëtare në përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa është znj. Vjosa Kida Hyseni, me të cilën plotësohet edhe kuota gjinore në komitet.

**Dardane Sogojeva Shala:** Kryesues i Kuvendit të Komunës, kjo pozitë i takon partisë së dytë politike në Kuvendin e Komunës.

**Ali Ismaili:** Zgjidhja e kësaj çështje është kuota gjinore, nuk është situatë e njëjtë me kërkesën për ndarjen në vite të përfaqësimit në Komitetin për Politikë dhe Financa, kur kemi qenë unë Driton Ademi, ndërsa pushteti e ka vendosur me votë si anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa z. Driton Hasolli, partia e të cilit ka patur më së paku vota në atë përbërje të Kuvendit të Komunës, kjo është e para për informim. E dyta mendimi im është të konsultohet edhe njëherë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pastaj të vendosim në mënyrë unanime për këtë punë. Duhet të kemi parasysh përbërjen e Kuvendit dhe përfaqësimin e të gjithëve, që ju e keni bërë mirë, sepse ne jemi trup i Kuvendit të Komunës, që japim vetëm rekomandime, nuk jemi organ vendim marrës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: Tani po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për rishqyrtimin e vendimit dhe ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa'.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa, e procedon për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për rishqyrtimin e vendimit dhe ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa'.

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit për rishqyrtimin e vendimit dhe ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa'.

Tani po e qesim ne votim 'Propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës për plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, me anëtaren e Kuvendit të Komunës znj. Vjosa Kida Hyseni'.
U votua me: dy vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej dy pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se nuk kalon propozimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, për plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, me anëtaren e Kuvendit të Komunës znj. Vjosa Kida Hyseni, në mungesë të votave.

**Pika e pestë (5) - Propozim për ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.**
**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale'. Hap diskutimin.
Tani meqë kjo punë u sqarua, po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale'.
U votua me: tre vota 'për', dy votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e aprovua për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale', me këtë::

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit për ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale'.

**Pika e gjashtë (6) - Propozim për rishqyrtimin e ndryshim-plotësimit të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026.**
**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për rishqyrtimin e ndryshim-plotësimit të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026', është cështje teknike që ka ardhur në rishqyrtim për të larguar paragrafin 3 të vendimit, ku përmendet pagesa e aksionarëve të KRM 'Pastrimi'. Hap diskutimin.
**Dardane Sogojeva Shala Ademi:** Funksioni i aksionarëve nuk është pjesë e strukturës së KRM 'Pastrimi', pagesa duhet të qartësohet, duhet të dihet kush është kompetentë.
**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: Meqenëse nuk ka diskutime tjera e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për rishqyrtimin e ndryshim-plotësimit të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026', duke e hequr paragrafin 3 të vendimit.
U votua me: tre vota 'për', dy votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e aprovua për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për rishqyrtimin e ndryshim-plotësimit të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026', duke e hequr paragrafin 3 të vendimit, me këtë::

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit për rishqyrtimin e ndryshim-plotësimit të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026', me kërkesën për heqjen e paragrafit 3 të vendimit.

**Pika e shtatë (7) - Shqyrtimi i dytë dhe ndryshim-plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: E kemi për shqyrtimin e dytë 'Rregulloren për Taksa Komunale', janë bërë rregullimet teknike në nenin 20 dhe nene tjera. Hap diskutimin.

**Ali Ismaili:** A ka ndonjë ndryshim nga shqyrtimi i parë, pse nuk është këtu ai që e ka sponzorizuar këtë rregullore, tani ne nuk kemi prej kujt të kërkojmë sqarime shtesë.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: Pasi që diskutime tjera nuk pati, po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtimin e dytë të 'Ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale'.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e aprovua për procedim dhe shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës të 'Ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e dytë të 'Ndryshim-plotësimit të Rregullores për Taksa Komunale'.

**Pika e tetë (8) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Planit Lokal për avansimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkalinjë të Komunës së Fushë-Kosovës për 2026-2029.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: E kemi për shqyrtimin e dytë 'Projekt-Planin Lokal për avansimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkalinjë të Komunës së Fushë-Kosovës për 2026-2029', është çështje teknike para dy muajve ka qenë në shqyrtimin e parë. Hap diksutimin.

**Ali Ismaili:** Edhe këtu vlenë e njëjta nuk kemi sqarime shtesë për 'Projekt-Planin Lokal për avansimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkalinjë të Komunës së Fushë-Kosovës për 2026-2029'.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: Pasi që diskutime tjera nuk pati po e qesim në votim për procedim në shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Planin Lokal për avansimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkalinjë të Komunës së Fushë-Kosovës për 2026-2029'.

U votua me: tre vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tre pjesëmarrës në votim nga gjithsej pesë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi shqyrtimin e dytë dhe procedoi në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Planin Lokal për avansimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkalinjë të Komunës së Fushë Kosovës për 2026-2029', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e dytë të 'Projekt-Planit të Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë dhe Ashkali të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029'.

**Pika e nëntë (9) - Informatë për performancën e Komunës së Fushë-Kosovës në vitin 2025.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: Besoj se këtë informatë e keni marrë në materialin e mbledhjes dhe ka të bëjë me performancën e komunës në vitin 2025, në nivel të Kosovës, po edhe të dhënat për komunën tonë. Hap diskutimin.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: Pasi që diskutime tjera nuk pati po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Informatën për performancën e Komunës së Fushë-Kosovës në vitin 2025'.

U votua me: tre vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tre pjesëmarrës në votim nga gjithsej pesë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi dhe procedoi për shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës 'Informatën për performancën e Komunës së Fushë-Kosovës në vitin 2025', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin dhe analizimin e 'Informatës për performancën e Komunës së Fushë-Kosovës në vitin 2025'.

**Pika e dhjetë (10) - Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi', me rekomandimin për shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, sipas shkresës së Ministrisë së Financave me Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026', për arsye se ndryshojnë mjete financiare në buxhet, andaj duhet të shfuqizohet ky vendim. Hap diskutimin.

Meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën për diskutim, po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare në shumë prej: 373,500.00€ për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi' dhe shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, sipas shkresës së Ministrisë së Financave me Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026'.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare në shumë prej: 373,500.00€ për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi' dhe 'Shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, sipas shkresës së Ministrisë së Financave me Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare në shumë prej: 373,500.00€ për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi' dhe 'Shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, sipas shkresës së Ministrisë së Financave me Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026'.

**Pika e njëmbëdhjetë (11) - Propozim për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën - programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën - programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës'. Hap diskutimin.

Meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën - programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës'.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën - programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën - programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës'.

**Pika e dymbëdhjetë (12) - Propozim për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për nën - programin 'Infrastruktura Rrugore'.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për nën - programin 'Infrastruktura Rrugore'. Hap diskutimin.

Meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, po e qesim në votim po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për nën - programin 'Infrastruktura Rrugore'.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për nën - programin 'Infrastruktura Rrugore', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për nën - programin 'Infrastruktura Rrugore'.

**Pika e trembëdhjetë (13) - Të ndryshme.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Tani dua të sqaroi dhe falënderoi të gjithë përfshirë organizimin dhe thirrjen e mbledhjes për miratimin e Deklaratës 'Jo në emrin tim', këtu fjalën e tyre e kanë thënë në mbledhje edhe znj. Aida Alimi dhe z. Migjen Kolshi, unë nuk kam të drejtë të mos ua jap fjalën atyre që e kërkojnë, nuk pajtohem me shkrimet në portale, që bëhen me tendencë, mbledhja ka qenë e mbajtur dhe e organizuar mirë, me nënshkrime të gjitha subjekteve politike, me përjashtim kuptohet të Listës Serbe.

**Ali Ismaili:** Këtë punë duhet të na sqaroni ju dhe z. Migjen Kolshi në mbledhjen e Kuvendit të Komunës nesër. Disa anëtarë të Kuvendit të Komunës nuk flasin tërë vitin, ndërsa e kërkojnë fjalën në mbledhjen e datës 26.09.2026, kjo qasje nuk është në rregullë.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:** Nuk ka patur asnjë skenar të ditur paraprakisht, kjo punë ka ndodhur në mbledhje, fjalën e merrë ai apo ajo që e kërkon, këtu nuk ka asnjë tendencë I nderuari z. Ali Ismaili.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në mbledhje.**
**Mbledhja përfundoi në ora 11:40 minuta.**

**Procesmbajtës**
**Hasan Gjyrevci**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Vlonjat Hasani**